

Indeksi i Integritetit Politik ¹

Rasti #2 – Lideri sindikal Blagoja Ralpovski, kryetar i Konfederatës së Sindikatave të Lira (KSL)

Hyrje

Në fokus të kësaj analize është përfaqësuesi sindikal Blagoja Ralpovski (kryetar i Konfederatës së Sindikatave të Lira – KSL), në kontekst të sjelljes së tij gjatë protestave për rritjen e pagës minimale dhe emërimin të tij të mëvonshëm si anëtar i Bordit Drejtues të Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor (FSPIM).

Rasti merr vëmendje publike në një periudhë të intensifikimit të aktiviteteve sindikale dhe paralajmërimeve për bllokim të Qeverisë për shkak të pakënaqësisë me nivelin e pagës minimale. Pyetja kyçe nga këndvështrimi i integritetit politik është nëse krijohet një perceptim i konfliktit ndërmjet autonomisë sindikale dhe një kooptim institucional të mundshëm përmes emërimit në një organ drejtues të një institucioni shtetëror.

Vlerësimi i integritetit politik: kategoria NJOLLË me vlerë negative –6

Sipas Metodologjisë së Indeksit të Integritetit Politik, në këtë rast ekzistojnë indikacione të dokumentuara publikisht për një konflikt të mundshëm interesi, si dhe fokus mediatik dhe debat publik, por mungon një përgjigje formale institucionale, reagim apo procedurë ligjore.

Bëhet fjalë për kategorinë “Njollë” (–4 deri –6), ku vlerësimi –6 i korrespondon një situatë në të cilën ekzistojnë dyshime etike dhe perceptim për mospërputhje, por pa paligjshmëri të konfirmuar. Në kuadër të Indeksit të Integritetit Politik, raste të tilla përfaqësojnë një “Njollë” – pra një sinjal paralajmërues për komprometim të mundshëm të integritetit, që kërkon shpjegim transparent dhe qartësi institucionale me qëllim ruajtjen e besimit të publikut.

¹ [Metodologjia e “Indeksit të Integritetit Politik”](#).

Kategori: Ndikimi i elitave

Argumentet kryesore

1. Mospërputhje ndërmjet qëndrimit sindikal dhe emërimit institucional

Në një periudhë kur Lidhja e Sindikatave të Maqedonisë (LSM) [paralajmëron dhe organizon protesta dhe grevë të përgjithshme për pagën minimale](#), në media është evidentuar se Ralovski [nuk ka marrë pjesë në protesta](#), ndërsa menjëherë pas kësaj është [emëruar si anëtar i ri në Bordin Drejtues të FSPIM](#).

Kjo krijon perceptimin e një kooptimi të mundshëm institucional. Përputhja kohore ndërmjet protestave dhe emërimit në një organ drejtues të një institucioni shtetëror hap çështje etike lidhur me autonominë e veprimit sindikal. Anëtarësimi në Bordin Drejtues të FSPIM përfaqëson një pozitë me interes publik, me ndikim mbi sistemin pensional.

Një lider sindikal që përfaqëson të drejtat e punëtorëve duhet të demonstrojë një distancë të qartë nga ndikimet e mundshme politike. Rasti zhvillohet në një periudhë të [kërkesave të shtuara sociale dhe paralajmërimeve për bllokada](#), gjë që e rrit më tej ndjeshmërinë e publikut ndaj kompromisave të mundshme ose marrëveshjeve joparimore ndërmjet sindikatave dhe pushtetit ekzekutiv.

Rekomandim për përgjegjësi individuale në funksion të mbrojtjes së integritetit:

Tërheqja e anëtarit të emëruar Ralovski nga Bordi Drejtues i FSPIM, me qëllim mbrojtjen e integritetit dhe rikthimin e besimit të qytetarëve në organizatën sindikale që ai udhëheq.

Dokumenti është përgatitur nga Forumi për Politika të Arsyeshme (FPR) si pjesë e punës sonë afatgjatë për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e Indeksit të Integritetit Politik. Analiza bazohet në të dhëna publike të disponueshme në media dhe në kriteret e përcaktuara të [indeksit](#).